

VENDIM
Nr.296, datë 16.5.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I
RRETHRROTULLIMIT DHE UNAZËS LINDORE, FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrethrotullimit dhe unazës lindore, Fier.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 121 m² tokë truall, të vlerësuar me 10 000 lekë/m², me vlerë të përgjithshme 1 210 000 (një milion e dyqind e dhjetë mijë) lekë dhe për objektin me vlerë 2 081 221 (dy milionë e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 3 291 221 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 3 291 221 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e një) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.5.2007 dhe të përfundojë më 15.6.2007.

7. Pronarët e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Deri në këto çaste paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I RRETHRROTULLIMIT DHE UNAZËS LINDORE, FIER**


Nr.	Emri	Nr.pas	Sip.m ² truall	Çmimi lekë/m ²	Objekt me vlerë lekë	Vlera lekë	Shënime
1	Agush Aqif Veliu	5/188	67	10 000		670 000	Plotësim dokumentacioni
2	Juljan Dashamir Mahmutaj	7/263	54	10 000	2 081 221	2 621 221	Plotësim dokumentacioni

	Totali					3 291 221	
--	--------	--	--	--	--	-----------	--

PLANIMETRIA E NDERTIMIT TE UNAZES FIER NGA PIK.1 - 7

$$L = 272.4 \text{ M}$$

SHK. 1:500



SHENIM

FRISHA L. SHKURTESI DHE BERGA E RE


Nga te dy krahet eshte parashikuar ndertimi i trotuarit nga 1.5 m deri ne 2 metra.


PRISHJA E SHIRIS DHE BERALEKE
et rakordimit bashkimit

[illegible]

DECLASSIFICATION E INDERTITTE URGATES FÜR NORDSYSTEM PROJECTI PK 28-32

0001-1000





KAZMIRA PLESATI
PROJEKTIM LIGJESISHTES
VLERESIM - NOLADIM
LIGJESISHTES NR. 1

Drejtoria e Llogjeres dhe
Vleresimit

KRYDREBIM!
(FIER - PATOS, VLORE - TIRANE)

PER FIER

PER PATOS

PER VLORE